



SBASHK Arsimimi sot

Qershor, 2024

Gazeta elektronike

Në Gjilan takim i suksesshëm me veprimtarët sindikal



Me aktivitetin në Gjilan është përmbyllur me sukses agenda e takimeve me veprimtarët sindikal nga të gjitha komunat e Kosovës. Ky aktivitet i SBASHK-ut është mbështetur nga Qendra Amerikane e Solidaritetit me seli në Tiranë dhe temë kyçe të debatit kishte doracakun për grevat e ligjshme... (faqe 4)

SBASHK vazhdon takimet me veprimtarë sindikal duke biseduar për grevat



Pas takimit me veprimtarët sindikal në Pejë e Gjakovë, ky aktivitet i mbështetur nga Qendra Amerikane e Solidaritetit, ka vazhduar në Prizren me veprimtarët sindikal nga ky qytet dhe nga Suhareka, ... (faqe 7)

Rëndësia e grevave të ligjshme në sektorin e arsimit në Kosovë



Në intervistën e muajit qershor, lidhur me nevojën për greva, ligjshmërinë dhe rëndësinë e tyre, na flet nga Instituti i... (faqe 3)

Me grupin e tretë të pushuesve në bregdetin shqiptar Respekt meritot dhe falënderime për SBASHK-un



Kanë arritur në Kompleksin Hotelier e Turistik "Bonita", pushuesit e grupit të tretë... (faqe 4)

203 mësimdhënës pushuan në Durrës nën organizimin e SBASHK-ut



Në bregdetin shqiptar, grupi i dytë prej 203 pushuesve e pushuesve nga shumë komuna të Kosovës krijuan atmosferë të shkëlqyer në ditën e katërt të pushimeve, organizuar nga SBASHK... (faqe 9)



Editorial

Dy aktivitete të veçanta të SBASHK-ut në qershor



Edhe muajin qershor SBASHK e ka përmbyllur me shumë aktivitete sindikale. Nga ato do veçuar organizimin me sukses të plotë të aktivitetit tradicional për pushimin e qindra anëtarëve të sindikatës sonë nga e tërë Kosova më bregdetin shqiptar. Dy grupet e para janë kthyer nga pushimet me përshtypje shumë të mira dhe grupi i tretë po kalon momente të bukura në bregdetin shqiptar për ta përmbyllur këtë aktivitet më 4 korrik. Një aktivitet tjetër i veçantë, që u përmbyll me sukses të plotë, është ai i takimeve me veprimtarë sindikal nga të gjitha komunat e Kosovës dhe universitetet. Ky aktivitet sindikal u organizua në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për

Drejtësi e në mbështetje nga Qendra Amerikane e Solidaritetit me seli në Tiranë. Në 7 takimet e mbajtura nëpër komunat e Kosovës është prezantuar doracak për grevat e ligjshme dhe është zhvilluar bashkëbisedë me pjesëmarrësit për çështjet e përfshira në doracak. Përfaqësuesit e Qendrës Amerikane të Solidaritetit dhe kryetari i SBASHK-ut kanë vlerësuar lartë këtë aktivitet duke përgëzuar nënkryetaren znj. Vjollca Shala, koordinatoren për organizim të brendshëm z. Ymer Ymeri, stafin e SBASHK-ut dhe stafin e Institutit të Kosovës për Drejtësi, për përkushtimin dhe kontributin që ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Rëndësia e grevave të ligjshme në sektorin e arsimit në Kosovë



Grevat në Kosovë, veqanërisht ato në sektorin e arsimit janë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe si të tilla janë të ligjshme.

Në intervistën e muajit qershor, lidhur me nevojën për greva, ligjshmërinë dhe rëndësinë e tyre, na flet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, z. Naim Jakaj.

Ai në këtë intervistë tregon për rëndësinë e grevave në sektorin e arsimit në Kosovë, përfitimet e mësimdhënësve dhe punonjësve tjerë të arsimit nga organizimi i grevave dhe pjesëmarrja në sindikatë e OJQ tjera në Kosovë.

Z. Jakaj në këtë intervistë flet për hartimin e Doracakut për grevat, si pikënisje e të cilit sipas tij ishte greva e mësimdhënësve e vitit 2022 në Kosovë.

Në këtë grevë z. Jakaj thotë se shumë të drejta të punonjësve arsimore u shkelën nga Qeveria e Kosovës, andaj theksoi se si e shtyu këtë organizatë që të hartoj edhe Doracakun i cili tashmë është në duar të mësimdhënësve.

SBASHK: Cila është rëndësia e Doracakut për grevat e ligjshme në sektorin e arsimit në Kosovë të hartuar nga IKD?

Jakaj: Instituti i Kosovës për Drejtësi, ka monitoruar në mënyrë të hollësishme grevën e SBASHK-un në vitin 2022. Gjatë ushtrimit të këtij instrumenti sindikal nga SBASHK-u, vërejtëm që institucionet e Kosovës, respektivisht Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e më vonë edhe vet Qeveria e Kosovës cenuan të drejtën kushtetuese dhe ligjore të aktivitetit sindikal, në këtë rast grevës së SBASHK-un. Ne pamë që ata kontestuan në vazhdimësi procedurën ligjore që ishte ndjekur me rastin e shpalljes së grevës në nivel vendi.

Por, për ne ishte e qartë, greva ishte organizuar në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Grevat, dhe duke parë një gjë të tillë ne morëm modelin e SBASHK-un, analizuam në hollësi parimet kushtetuese, ligjet në fuqi dhe standardet ndërkombëtare dhe vendosëm të përpilojmë një doracak ku aty do të tregonin në detaje, hap pas hapi, çdo rrugë që duhet të ndjek një sindikatë për t'u konsideruar një grevë e ligjshme. Këtij doracaku

do t'i bashkëngjiten edhe format e shkresave të cilat do ta lehtësojnë dhe do t'u ndihmojnë në masë të madhe sindikatave.

SBASHK: Çka i ndihmon mësimdhënësit, përfaqësuesit tjerë të arsimit dhe sindikatat e tjera në Kosovë ky dokument?

Jakaj: E thashë edhe në pyetjen e parë, se modeli që ne kemi marrë për shkrimin e Doracakut ka qenë organizimi në pajtim me ligjin dhe puna transparente e SBASHK-ut. Mësimdhënësve, do t'u ndihmojë në masë të madhe tani e tutje për secilin hap, e fillimisht për zhvillimin e dialogut social dhe komunikimin me Qeverinë që të arrijë marrëveshje për kërkesat që ata mund të kenë. Por, Doracaku do të ketë shtrirje më të gjerë se sa vetëm për mësimdhënësit, Doracaku do të jetë i dobishëm për të gjitha sindikatat që veprojnë në Kosovë dhe veqanërisht për ato që janë më të vogla, duke u'a lehtësuar angazhimin dhe përfshirjen në aktivitete sindikale për të realizuar të drejtat e tyre me shfrytëzimin e mekanizmit kushtetues dhe ligjor të grevave.

SBASHK: Cila është rëndësia e bashkëpunimit të IKD-së me SBASHK-un?

Jakaj: Bashkëpunimi midis shoqërisë civile dhe sindikatave është thelbësor për avancimin e të drejtave të punëtorëve dhe fuqizimin e tyre karrshi institucioneve publike. IKD, në vazhdimësi u ndihmon grupeve të caktuara sociale dhe grupeve të cenuara përmes Qendrës për Ndihmë Juridike Falas, veqanërisht për mësimdhënësit kur ata kalojnë në pension. Si IKD, ne konsiderojmë se bashkëpunimi me SBASHK-un, ka sjellur ekspertizë në çështjet e drejtësisë sociale, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik. Në anën tjetër, në të ardhmen presim që bashkëpunimi me SBASHK-un do të mund të jetësohet përmes ofritit të mbështetjes ligjore dhe edukative për mësimdhënësit, duke i ndihmuar ata të kuptojnë më mirë të drejtat e tyre dhe mënyrën se si mund të luftojnë për to.

SBASHK: Cila janë bashkëpunimet e tjera të IKD-së me SBASHK-un?

Jakaj: Si IKD, në bashkëpunim me SBASHK-un ne patëm edhe një sukses të përbashkët. Si rezultat i angazhimit dhe presionit të përbashkët, është shpallur konkursi për përfaqësimin e sindikatave në Bordin e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës. Kjo pozitë ka mbetur pa u shpallur që nga muaji korrik i vitit 2023 duke u cenuar përfaqësimi i punëtorëve në këtë bord të rëndësishëm. Ky lloj i bashkëpunimit, dhe angazhimi në të ardhmen e afërt, do të luaj rol kyç në ngritjen e zërit të punëtorëve në forumet publike dhe politike. Do të përdorim secilën platformë publike përë avokim për

politika më të mira pune dhe legjislacion që mbështet të drejtat e punëtorëve.

Bashkëpunimi tjetër me SBASHK-un, konsiderojmë se mund të shtrihet te ndihma e jonë për sindikatën në hartimin e dokumentacionit ligjor, hartimin e strategjive të tyre organizative dhe komunikimit të përditshëm publik. Konsiderojmë se vetëm duke punuar së bashku, mund të ndërtojmë një front të bashkuar që jo vetëm mbron të drejtat e punëtorëve, por edhe promovon një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë.

SBASHK: Çfarë mesazhi do të dëshironit t'i përcillnit punëtorëve që nuk janë ende të përfshirë në sindikata apo aktivitete të shoqërisë civile?

Jakaj: Mesazhi ynë si IKD, për mësimdhënësit që nuk janë ende të përfshirë në sindikata apo aktivitete të shoqërisë civile është ky: pjesëmarrja juaj është vendimtare për të përmirësuar kushtet e punës dhe mbrojtjen e të drejtave tuaja. Duke u bashkuar me sindikata e për më shumë edhe me organizata të shoqërisë civile, ju do të fitoni një zë më të fortë dhe një rrjet të mbështetjes që mund t'ju ndihmojë në sfidat që i hasni në vendin e punës.

Vetëm duke u përfshirë në SBASHK dhe aktivitete të saj dhe ju keni mundësinë të ndikoni drejtpërdrejt në vendimmarrje dhe të siguroheni që zëri juaj të dëgjohet. Kjo pjesëmarrje jo vetëm që ju fuqizon ju si individë, por edhe forcon komunitetin tuaj të punës.

Gjatë muajit

Me grupin e tretë të pushuesve në bregdetin shqiptar



Kanë arritur dje në Kompleksin Hotelier e Turistik “Bonita”, pushuesit e grupit të tretë, të cilët edhe përmbyllin këtë aktivitet tradicional, që SBASHK organizon për qindra anëtare e anëtarë nga të gjitha

komunat e Kosovës dhe universitetet.

Kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj, të dielën ka vizituar pushuesit e grupit të tretë, të cilët i kanë dëshiruar mirëseardhje duke shprehur respektin meritot dhe falënderime për SBASHK-un për gjithë angazhimet në shërbim të anëtarësisë. Ata kanë bërë shumë foto me kryetarin dhe koordinatorin për organizim të brendshëm në SBASHK, z. Ymer Ymeri, për t'i ruajtur kujtim nga ditët e kaluara në bregdetin shqiptar.

Edhe pushuesit e grupit të tretë, gjatë ditëve që po kalojnë buzë detit shqiptar po bashkëbisedojnë për arsimin dhe misionin e shenjtë për edukimin e arsimimin e brezave, por po shpalosin edhe kujtime nga vitet e dekadat e kaluara dhe po ndjehen arsyeshëm krenar për punën dhe përkushtimin në misionin e tyre për arsimimin e gjeneratave dhe për unitetin në sindikatën e tyre duke e thënë zëshëm, Bashkë e në SBASHK.

Në Gjilan takim i suksesshëm me veprimtarët sindikalt

Me aktivitetin në Gjilan është përmbyllur me sukses agenda e takimeve me veprimtarët sindikalt nga të gjitha komunat e Kosovës. Ky aktivitet i SBASHK-ut është mbështetur nga Qendra Amerikane e Solidaritetit me seli në Tiranë dhe temë kyçe të debatit kishte doracakun për grevat e ligjshme.

Në hapje të takimit në Gjilan zyrtarja e lartë e Qendrës

Amerikane të Solidaritetit, znj. Bruna Hylviu, ka përshëndetur veprimtarët sindikalt nga Gjilani, Kamenica, Vitia, Klllokoti dhe univeristeti. Znj. Hylviu pastaj ka treguar për angazhimet e Qendrës në mbështetje të sindikatave duke veçuar bashkëpunimin e frytshëm me SBASHK-un. Ajo është shprehur se edhe në të ardhmen do të vazhdohet me bashkëpunimin duke



forcuar zërin sindikal.

Kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj, ka treguar se me takimin në Gjilan po përmbyllet me sukses ky aktivitet duke prezantuar Doracakun për grevat e ligjshme, që është përgatitur nga Instituti i Kosovës për Drejtësi. Ai ka falënderuar Qendrën Amerikane të Solidaritetit për mbështetjen dhe ka kujtuar edhe bashkëpunimin me vite e dekada me Sindikatën e Mësuesve të Amerikës.

Në pjesën e dytë të takimit, zyrtarja e lartë e IKD-së, znj. Arrita Rezniciq, ka prezantuar Doracakun duke u

ndalur në të gjitha çështjet e përfshira dhe duke dhënë sqarime të duhura.

Pas kësaj, znj. Rezniciq bashkë me kryetaren e SBASHK-ut, znj. Vjollca Shala, me zyrtaren e lartë të Qendrës Amerikane të Solidaritetit znj. Bruna Hylfiu dhe me kryetarin e Sindikatës së Arsimit Fillor e të Mesëm të Ulët, z. Blerim Mehmeti, kanë zhvilluar bashkëbisedë me pjesëmarrësit lidhur me Doracakun duke theksuar se do të vazhdohet me dialog, por SBASHK do të respektojë vullnetin e anëtarësisë për veprime sindikale nëse Qeveria vazhdon t'i ikë dialogut.

Takime të sukseshme e përmbajtësore të SBASHK-ut edhe në Prishtinë e Mitrovicë



SBASHK-u i përkrahur nga Qendra Amerikane të Solidaritetit ka vazhduar të realizojë aktivitetin e takimeve me veprimtarë sindikal nga të gjitha komunat për të prezantuar Doracakun lidhur me shpalljen e grevave të ligjshme, që është përgatitur nga Instituti i Kosovës për Drejtësi.

Ky aktivitet ka filluar në Pejë për të vazhduar në Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Prishtinë, Mitrovicë për ta përmbyllur këtë agjendë me takimin e së premtes së 28 qershorit në Gjilan.

Në takimin me veprimtarë sindikal nga Prishtina, Podujeva, Drenasi, Fushë Kosova, Obiliqi e universiteti që u mbajt në Prishtinë zyrtarja e lartë e Qendrës Amerikane të Solidaritetit, znj. Bruna Hylviu, ka treguar fillimisht për angazhimet e kësaj qendre duke vlerësuar lart bashkëpunimin me SBASHK e duke kujtuar shembuj konkret të aktiviteteve të përbashkëta me qëllim të forcimit të vazhdueshëm zërin sindikal.

Kryetari i SBASHK-ut z. Rrahman Jasharaj, duke përshëndetur pjesëmarrësit ka falënderuar pjesëmarrësit duke shprehur respekt meritore për Qendrën Amerikane

të Solidaritetit e duke përgëzuar Institutin e Kosovës për Drejtësi për gjithë angazhimet dhe për përgatitjen dhe publikimin e Doracakut lidhur me shpalljen e grevës së ligjshme.

Në pjesën e dytë të takimit përfaqësuesit e Institutit të Kosovës për Drejtësi, z. Naim Jakaj e znj. Arrita Rezniciq, kanë prezantuar doracakun e pastaj bashkë me nënkryetaren e SBASHK-ut znj. Vjollca Shala, kanë bashkëbiseduar me pjesëmarrësit, të cilët kanë lavdëruar këtë aktivitet dhe kanë shtruar edhe pyetje duke marrë përgjigje të argumentuara.

Takim i suksesshëm e përmbajtësor u zhvillua edhe me veprimtarë sindikal të Mitrovicës, Skënderajt, Vushtrisë, Leposaviqit, Zveçanit dhe universitetit. Në hapje të takimit zyrtarja e lartë e Qendrës Amerikane të Solidaritetit, znj. Bruna Hylviu, ka treguar për aktivitetet e kësaj Qendre për të shprehur respekt për angazhimet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë e duke premtuar mbështetje edhe në të ardhmen për ta forcuar zërin sindikal.

Kryetari Jasharaj edhe në Mitrovicë ka falënderuar Qendrën Amerikane të Solidaritetit për mbështetjen e vazhdueshme në angazhimet sindikale dhe Institutin e Kosovës për Drejtësi për bashkëpunim duke e përgëzuar për angazhimet në mbrojtje të drejtësisë dhe të drejtave të individëve dhe organizata, që u janë cenuar të drejtat



dhe liritë njerëzore dhe për përgatitjen dhe publikimin e Doracakut për shpalljen e grevave të ligjshme.

Në pjesën e dytë të takimit, përfaqësuesit e IKD-së, z. Naim Jakaj e z. Gëzim Shala, kanë prezantuar doracakun e pastaj bashkë me nënkryetaren, znj. Vjollca Shala kanë zhvilluar bashkëbisedë me pjesëmarrësit lidhur me Doracakun duke u përgjigjur edhe në pyetjet e pjesëmarrësve për veprimet sindikale dhe për çështje të tjera sindikale.



Vazhdojnë takimet e SBASHK-ut me veprimtarë sindikal nëpër komuna



SBASHK-u i përkrahur nga Qendra Amerikane e Solidaritetit e në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Drejtësi ka vazhduar të realizojë agjendën e takimeve me veprimtarë sindikal për të bashkëbiseduar për doracakun e grevës së ligjshme.

Një takim i suksesshëm e përmbajtjesor ishte edhe në Ferizaj në të cilin morën pjesë anëtare e anëtarë të SBASHK-ut nga ky qytet dhe nga Kaçaniku, Hani i Elezit, Shtimja, Shterpca dhe Universiteti.

Në hapje të takimit në Ferizaj, që u zhvillua në orët e pasdites së 26 qershorit, zyrtarja e lartë e Qendrës Amerikane të Solidaritetit, znj. Bruna Hylviu, ka

përgëzuar SBASHK-un për angazhimet e vazhdueshme në shërbim të anëtarësisë dhe ka premtuar se do të vazhdohet me bashkëpunimin për ta forcuar edhe më shumë zërin sindikal.

Zonja Hylviu ka shprehur respekt meritot edhe për Institutin e Kosovës për Drejtësi për gjithë angazhimet dhe për doracakun për grevat e ligjshme.

Kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj, ka falënderuar Qendrën Amerikane të Solidaritetit për mbështetjen e vazhdueshme në realizimin e aktiviteteve të shumta sindikale.

Jasharaj ka përgëzuar Institutin e Kosovës për Drejtësi për gjithë angazhimet, bashkëpunimin korrekt dhe për përgatitjen e Doracakut për grevat e ligjshme.

Në vazhdim të këtij aktiviteti, përfaqësuesi i IKD-së, z. Naim Jakaj ka prezantuar Doracakun e pastaj ai bashkë me nënkryetaren e SBASHK-ut, znj. Vjollca Shala, koordinatoren për organizim të brendshëm z. Ymer Ymeri dhe zyrtaren e lartë të Qendrës Amerikane të Solidaritetit, znj. Bruna Hylviu, kanë bashkëbiseduar me pjesëmarrësit për Doracakun dhe veprimet sindikale e veçmas për grevën e përgjithshme.

Kjo agjendë do të vazhdojë me takimet në Prishtinë e Mitrovicë për t'u përmbyllur ky aktivitet më 28 qershor në Gjilan.



SBASHK vazhdon takimet me veprimtarë sindikal duke biseduar për grevat



Pas takimit me veprimtarët sindikal në Pejë e Gjakovë, ky aktivitet i mbështetur nga Qendra Amerikane e Solidaritetit, ka vazhduar në Prizren me veprimtarët sindikal nga ky qytet dhe nga Suhareka, Dragashi, Mamusha e univeristeti.

Pjesë e këtij aktiviteti sindikal janë edhe përfaqësuesit e Institutit të Koosvës për Drejtësi, z. Naim Jakaj dhe znj. Arrita Reznici, të cilët kanë prezantuar doracakun për shpalljen e grevës së ligjshme, që e kanë përgatitur në bashkëpunim me SBASHK-un.

Ashtu si në Pejë e Gjakovë edhe në Prizren nga pjesëmarrësit kanë uruar që Qeveria të ndryshojë qasjen dhe të nisë dialogun me mirëfilltë me SBASHK-un e nëse kjo nuk ndodhë, atëherë ata kanë shprehur shqetësimin se anëtarësia do të kërkojë veprime sindikale duke mos përjashtuar as grevën e përgjithshme në shtator.

Edhe në takimin në Prizren, drejtori i Qendrës Amerikane të Solidaritetit me seli në Tiranë, z. Steven McCloud ka treguar për angazhimet e qendrës që drejton, duke shtur se do të vazhdohet me bashkëpunimin për të forcuar edhe më shumë zërin sindikal.



Kryetari i SBASHK-ut z. Rrahman Jasharaj edhe në Prizren ka përgëzuar veprimtarët sindikalë për përkushtimin duke falënderuar z. Seven për gjithë angazhimet në mbështetje të SBASHK-ut e duke kujtuar me krenari miqësinë e krijuar në vitet e vështira për arsimin shqip me Sindikatën e Mësuesve të Amerikës dhe me sindikata simotra nga vende të Evropës e botës.

Jasharaj ka përsëritur se sindikata do të vazhdojë me angazhimet që të ketë dialog e të bëhet realizimi i kërkesave legjitime të anëtarësisë, që u publikuan edhe në protestën e 1 majit, por nëse qeveria vazhdon me qasjen e gabuar ndaj sindikatës dhe dialogut, atëherë do t'i shtërnojmë radhët dhe do të nisim me veprime sindikale duke mos përjashtuar edhe grevën e përgjithshme duke respektuar kështu zërin e vullnetin e anëtarësisë.



Bashkëbisedën me veprimtarët sindikalë edhe në Prizren e kanë zhvilluar nënkryetarja e SBASHK-ut, znj. Vjollca Shala, koordinatori për organizim të brendshëm z. Ymer Ymeri dhe përfaqësuesi i IKD-së z. Naim Jakaj duke u përgjigjur edhe në pyetjet e pjesëmarrësve të këtij aktiviteti duke e prezantuar edhe përmbajtjen e doracakut për shpalljen e grevës së ligjshme.

Në takimet e veprimtarëve sindikal në Pejë, Gjakovë e Prizren ishte porosi të vazhdohet me përpjekjet që të ketë dialog për realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë, por nëse Qeveria vazhdon me qasjen e gabuar, atëherë do të shkohet me veprime sindikale duke mos përjashtuar edhe grevën e përgjithshme në tërë sistemin arsimor të Kosovës.

Takime të tilla për të biseduar për grevat e për ta prezantuar doracakun për shpalljen e grevës së ligjshme do të mbahen edhe me veprimtarë sindikalë nga komuna tjera të Kosovës.



SBASHK ka nisur takimet me veprimtarë sindikal duke biseduar për grevat



SBASHK duke vazhduar bashkëpunimin me Qendrën Amerikane të Solidaritetit ka nisur takimet me veprimtarë sindikal nga komunat dhe universitetet e Kosovës.

Ky aktivitet ka filluar të martën e 25 qershorit me veprimtarë sindikal nga Peja, Istogu, Klina, Deçani e Juniku e për të vazhduar me veprimtarë sindikal nga Gjakova, Malisheva e Rahoveci.

Në këtë takim, përfaqësuesit e Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD) Naim Jakaj dhe Arrita Rezniki kanë prezantuar doracakun për shpalljen e grevës së ligjshme. Ky aktivitet do të vazhdojë edhe me veprimtarë sindikal nga komunat tjera të Kosovës dhe të universiteteve.

Në hapje të këtij aktiviteti sindikal në Pejë e Gjakovë drejtori i Qendrës Amerikane të Solidaritetit për Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut me seli në Tiranë, Steven McCloud ka treguar për angazhimet e qendrës që drejton duke përgëzuar SBASHK-un për gjithë angazhimet në shërbim të anëtarësisë e duke shtuar se do të vazhdohet me bashkëpunimin për të forcuar edhe më shumë zërin sindikal.



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka përgëzuar veprimtarët sindikal për përkushtimin duke falënderuar

z. Seven për gjithë angazhimet në mbështetje të SBASHK-ut e duke kujtuar me krenari miqësinë e krijuar në vitet e vështira për arsimin shqip me Sindikatën e Mësuesve të Amerikës dhe me sindikata simotra nga vende të Evropës e botës.



Jasharaj është shprehur se sindikata do të vazhdojë me angazhimet që të ketë dialog e të bëhet realizimi i kërkesave legjitime të anëtarësisë, që u publikuan edhe në protestën e 1 Majit, por nëse qeveria vazhdon me qasjen e gabuar ndaj sindikatës dhe dialogut, atëherë do t'i mobilizojmë radhët dhe do të nisim me veprime sindikale duke mos përjashtuar edhe grevën e përgjithshme duke respektuar zërin e vullnetin e anëtarësisë.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut, nënkryetarja Vjollca Shala dhe përfaqësuesit e Institutit të Kosovës për Drejtësi kanë bashkëbiseduar me pjesëmarrësit për përmbajtjen e doracakut për grevat dhe janë përgjigjur edhe në pyetjet e këtyre veprimtarëve sindikal.

Në takimet e veprimtarëve sindikal në Pejë e Gjakovë ishte porosi të vazhdohet me përpjekjet që të ketë dialog për realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë, por nëse Qeveria vazhdon me qasjen e gabuar, atëherë do të shkohet me veprime sindikale duke mos përjashtuar edhe grevën e përgjithshme në tërë sistemin arsimor të Kosovës.



203 mësimdhënës pushuan në Durrës nën organizimin e SBASHK-ut



Në bregdetin shqiptar, grupi i dytë prej 203 pushueseve e pushuesve nga shumë komuna të Kosovës krijuan atmosferë të shkëlqyer në ditën e katërt të pushimeve, organizuar nga SBASHK.

Mësimdhënësit të cilët frekuentuan bregdetin shqiptar që nga dita e mërkurë e kësaj jave, janë pjesë e grupit të dytë të mësimdhënësve nga gjithsej tri grupe që SBASHK i ka caktuar për pushim gjatë këtij viti.

Mësimdhënësit në Durrës u shoqëruan nga kryetari i SBASHK-ut, z. Rahman Jasharaj si dhe koordinatori

për organizim të brendshëm, z. Ymer Ymeri të cilët u kujdesën për mbarëvajtjen e pushimit.

Mësimdhënësit të cilët qëndruan në Durrës gjatë këtyre ditëve, janë shprehur të kënaqur për organizimin e pushimit 5-ditor nga ana e SBASHK-ut.

Dhe gjatë javës së ardhshme, në bregdetin shqiptar pritet të shkoj edhe grupi i tretë i pushuesve i cili do të përmbyll aktivitetin e pushimeve për këtë vit.

SBASHK gjatë kësaj vere ka organizuar pushim për 440 punonjës arsimor.



Vazhduan trajnimet për mësimdhënës nëpër komuna të ndryshme të Kosovës

SBASHK ka vazhduar organizimin e trajnimeve të ndryshme në disa komuna të Kosovës edhe gjatë këtij vikendi.

Të shtunën është mbajtur trajnimi “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” në Kaçanik, i cili po mbahet nga trajneri i caktuar nga SBASHK-u, Avni Krasniqi.

Po ashtu të shtunën u mbajt trajnimi “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” nga trajnerë Kadri Hyseni dhe Nexhmedin Gruda, në

Ferizaj.

Të shtunën është mbajtur edhe trajnimi “Roli i aktiviteteve kreative në mësimdhënie dhe zbatimi i tyre në shkolla fillore” nga trajneri Ahiret Mehmeti në Prizren dhe trajnimi “Roli i mësimdhënësve për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës” i mbajtur nga trajnerja Drita Kamberi.

Po ashtu po vazhdon trajnimi “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” në Pejë nga trajneri Burim Krasniqi.



Grupi i dytë i pushuesve të SBASHK-ut arriri në bregdetin shqiptar

Teksa të 88 pushuesit e grupit të parë kanë përfunduar pushimin e organizuar nga SBASHK-u në bregdetin shqiptar duke bërë forografi të shumta që të ruajnë kujtimet nga ky aktivitet tradicional, në bregdetin shqiptar po sot ka arritur grupi i dytë prej 203 anëtarëve e anëtarëve të SBASHK-ut, që janë përzgjedhur nga shoqatat sindikale nga shumë komuna të Kosovës.

Kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj, duke u përshëndetur me grupin e parë i ka përgëzuar ata për qëndrimin e dinjitetshëm dhe ka shprehur respekt për koordinatorin për organizim të brendshëm z. Ymer Ymeri dhe stafin qendror që po bëjnë angazhime maksimale për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti.

Kryetari Jasharaj ka përshëndetur edhe pushuesit e grupit të dytë duke ju dëshiruar momente të bukura buzë valëve të detit shqiptar. Jasharaj është shprehur i bindur se edhe pushuesit e grupit të dytë do të kenë sjellje dinjitoze dhe do ta ruajnë figurën e punëtorit arsimor dhe emrin e respektuar të SBASHK-ut.



U mbajt testi për programin e trajnimit “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” në tri module

Të hënë në shkollën Fillore të Mesme të Ulët, “Vatra e Diturisë” në Livoç, Gjilan u organizua testimi i mësimdhënësve-anëtarë të SBASHK-ut, për trajnimin e përfunduar në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.

Testimi i organizuar nga SBASHK u mbikqyr nga Nënkryetaria e SBASHK-ut, znj. Vjollca Shala, e cila u dëshiroi mësimdhënësve përvetësim sa më të lartë të njohurive të fituara gjatë trajnimit. Në trajnim mori pjesë

edhe trajneti i ckatuar nga SBASHK-u, Musli z. Neziri, i cili e udhëhoqi trajnimin për shtatë ditë me radhë për grupin e mësimdhënësve.

Testi i programit “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” u mbajt në tri module: Word, Excel dhe Power Point.

SBASHK vazhdon trajnimet e organizuara nëpër komuna të ndryshme si Pejë, Prizren, Kaçanik dhe komuna tjera në Kosovë.



Grupi i parë i pushuesve-anëtarë të SBASHK-ut, qëndruan në bregdetin shqiptar.



Janë 88 anëtarë të SBASHK-ut që po qëndrojnë në bregdetin shqiptar. Grupi i parë i mësimdhënësve të cilët e kanë filluar edhe ciklin e pushimeve verore 2024, kanë udhëtuar për Durrës në ditën e premte derisa janë ndarë të kënaqur me akomodimin, kushtet dhe organizimin e SBASHK-ut.

Me grupin e parë të mësimdhënësve në Durrës, po qëndron edhe Koordinatori për Organizim të Brendshëm,



z. Ymer Ymeri i cili po kujdeset për mbarëvajtjen e udhëtimit dhe qëndrimin sa më komod të pushuesve në bregdet.

Ata sot i kanë uruar njëri-tjetrit Kurban Bajramin duke drekuar bashkë në një atmosferë festive të krijuar nga stafi i Kompleksit Hotelier “Bonita”.


Kryetari i SBASHK-ut është kyçur në grupin e pushuesve dhe u ka dërguar urime për festën e madhe të Kurban

Bajramit. Kryetari Jasharaj duke iu drejtuar pushuesve ka shkruar: “I nderur kolegu Ymer, të nderuara kolege e kolegë që jeni duke pushuar në bregdetin shqiptar organizuar nga SBASHK ju përshëndes. Urime e me fat festa e madhe e Kurban Bajramit. Gëzime e festa paçi gjithmonë.”

Ky aktivitet tradicional vazhdon me grupin e dytë, që udhëton për në Durrës më 19 qershor dhe përmbyllet me grupin e tretë, që nisët për në bregdetin shqiptar më 29 qershor.



Këtë vit SBASHK dërgon 440 anëtarë në bregdetin shqiptar



Edhe këtë vit SBASHK-u ka vazhduar me aktivitetin tradicional për dërgimin e një numri të konsideruar të anëtareve e anëtarëve në bregdetin shqiptar në shenjë të respektit për përkushtimin e tyre në arsimimin dhe

edukimin e brezave nëpër vite e dekada.

Ky aktivitet këtë vit ka nisur sot me grupin e parë prej 88 pushuesve, për të vazhduar më 19 qershor me grupin e dytë prej 203 pushuesve dhe për t’u përmbyllur me grupin e tretë prej 149 pjesëmarrësve në këtë aktivitet rekreativ, të cilët për në bregdetin shqiptar do në nisen më 29 qershor.

Përzgjedhja e pushuesve është bërë nga shoqatat

sindikale që nga çerdhet e deri të universitetet e institucionet e kulturës, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara nga Këshilli Drejtues i SBASHK-ut.

Kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj, është krenar që ky aktivitet po vazhdon sepse është shprehje e mirënjohjes për angazhimet e vazhdueshme e maksimale të këtyre pushuesve në shërbim të arsimit dhe kulturës.

Z. Jasharaj përgëzon koordinatoren për organizim të brendshëm z. Ymer Ymeri, stafin qendror dhe kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve për angazhimet maksimale me qëllim që ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë.

Ai shprehet se edhe shumë anëtare e anëtarë të SBASHK-ut e meritojnë një dhuratë të tillë, por kaq janë mundësitë bazuar në mjetet e akumuluar për pushim dhe rekreacion.

Në Mitrovicë përfundoi trajnimi “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe u mbajt testi në tri module

Në Mitrovicë përfundoi trajnimi i mësimdhënësve në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” si dhe u mbajt testi në tri module.

Trajnimi për grupin e mësimdhënësve të Mitrovicës u mbajt nga trajneri i zgjedhur nga SBASHK-u, Fevzi Selmani.

Ndërkohë, një grup i mësimdhënësve në këtë komunë mbajtën edhe testin në tri module: Word, Exel dhe Power Point.

SBASHK vazhdon organizimin e trajnimeve edhe gjatë ditëve të ardhshme për mësimdhënës në komuna të ndryshme të Kosovës.



Filloi trajnimi “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” për anëtarët nga Peja



Sot në Pejë filloi trajnimi i organizuar nga SBASHK-u i cili është i licencuar nga MASHTI.

Trajnimit “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” iu nënshtruan një grup i mësimdhënësve në Pejë, derisa ata u vizituan edhe nga kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj.

Kryetari i i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj përcolli mbarëvajtjen e trajnimit derisa mësimdhënësve pjesëmarrës iu dëshiroi sukses.

Z. Jasharaj ka thënë që pavarësisht vështirësive, SBASHK do të vazhdojë të përkrah anëtarësinë e saj përmes trajnimeve dhe formave tjera që u shërbejnë atyre për zhvillim profesional.

I pranishëm në trajnim ishte edhe kryetari i SKAP-Pejë z. Isuf Lajqi.

Trajnimi i filluar sot po mbahet nga trajneri i caktuar nga SBASHK-u z.Burim Krasniqi.



Përfaqësues nga SBASHK morën pjesë në përmbylljen e fazës së parë të projektit “Aftësim për tregun e punës”



Përfaqësues të SBAHK-ut kanë marrë pjesë në përmbylljen e fazës së parë të projektit gjermano-kosovar, “Aftësim për tregun e punës” i mbështetur nga Qeveria e Gjermanisë në Kosovë.

Në përmbyllje të këtij projekti gjerman në Kosovë i cili u mbajt në shkollën Fillore të Mesme të Ulët, “Xhemail Mustafa” në Prishtinë, mori pjesë Nënkryetari i SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe Koordinatori për Organizim të Brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri.

Kjo ceremoni u mbajt me rastin e përmbylljes së fazës së parë të projektit gjermano-kosovar “Aftësim për tregun e punës”, ku ishte i pranishëm edhe Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde.

Fjalën hyrëse në këtë ceremoni e bëri drejtoresha e shkollës “Xhemail Mustafa”, Shpresa Shala derisa fjalë rasti pati edhe ministria e Arsimit, Arbërie Nagavci. Në këtë ceremoni, u bë edhe prezantimi i nxënësve të shkollës “Nazim Gafurri” nga Prishtina dhe ai i shkollës “Selman Riza” nga Gjakova.

Në përmbyllje të kësaj ceremonie u bë edhe certifikimi i pjesëmarrësve në trajnimet: Edukimi në Karrierë, Këshillimi në Karrierë dhe Kompetenca Digjitale.

E ndajmë dhembjen dhe pikëllimin me kolegun tonë Vloranin

Kishim lexuar në medie për një ngjarje të tmerrshme në komunikacion dhe dhembja ishte e madhe për fëmijën dhe nënën e saj të vdekur. Kryefamiljari ka lëndme të rënda thoshin mediet. Dhembja na u shtua edhe më shumë kur kuptuam se kjo ngjarje tragjike i kishte ndodhur kolegut tonë Vloran Krasniqi, që është kryetar i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar në Dragash. Komunikuam me kolegët nga komunat e ndryshme dhe bashkërisht e me plot dhembje e pikëllim shkua në Spitalin e Prizrenit dhe e vizituam Vloranin. Bashkëbiseduam me të duke u munduar që me ndonjë lot të mos ia lëndojmë plagët e zemrës se plagët e ndeshjes në komunikacion bënin çmos t'ia shëronin personeli mjekësor. U larguam më heret se sa që kishim planifikuar sepse loti po na tradhëtonte.

Nga spitali shkua në fshatin e Vloranit dhe morem pjesë në ngushëllime. Burrat po mbaheshin të fortë, por dhembja e pikëllimi u hetohej lehtë në fytyrë. Ata na



shprehën respekt për gjithë rrugën e bërë që të ndajmë dhembjen me ta dhe bashkërisht u lutem që tragjedi të tilla të mos ndodhin kurrë më.

Kryesia e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), vizitoi shkollën Fillore të Mesme të Ulët “Iliria” në Prishtinë



Kryesia e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës SBASHK, vizitoi shkollën Fillore të Mesme të Ulët “Iliria” në Prishtinë, ku u prit nga drejtoresha e shkollës, znj. Drita Nishevci.

Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, e përgëzoi drejtoreshën për punën e bërë si në cilësinë e arsimit ashtu edhe në përmirësimin e infrastrukturës shkollore. Në takim u diskutua funksionalizimi i Sindikatës së shkollës ku pritet të zgjidhet edhe kryetari i saj, pasi ish kryetari i sindikatës në këtë shkollë Adem Latifi ka ndërruar jetë muaj më parë.

Drejtoresha premtoi mbështetje në organizimin dhe fuqizimin sindikal të shkollës për të cilën tha se do të kontribuojë edhe në përmirësimin e kushteve të mësimdhënësve por edhe nxënësve dhe ambientin e shkollës.



Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), ka mbajtur takimin e radhës me Kryetarët e Niveleve Komunale dhe të Universiteteve të Sindikatës, ku i ka diskutuar zhvillimet rreth vizitës së mësimdhënësve në bregdetin shqiptar.

Në takim, fjalën përshëndetëse e bëri kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj. Ai i uroi pushime të këndshme të gjithë mësimdhënësve që këtë vit do ta frekuentojnë bregdetin shqiptar me organizim nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës. Kurse, nënkryetarja e Sindikatës, Vjollca Shala, tha se

listat e mësimdhënësve të cilët do të shkojnë në pushim me organizimin e SBASHK-ut, janë në procedurë të verifikimit.

Ndërsa, Koordinatori për Organizim të Brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri tha se numri i pjesëmarrësve është rritur në mbi 400 mësimdhënës që do të pushojnë sivejt në bregdetin shqiptar. Ymeri kërkoi respektimin e vendimeve të nxjerra nga sindiakta në mënyrë që të mos ndodhin probleme në akomodimin e mësimdhënësve në bregdetin shqiptar, ku mësimdhënësit do të qëndrojnë për 5 netë.

SBASHK mbajti takimin e radhës me Kryetarët e Niveleve Komunale dhe të Universiteteve të Sindikatës


Detyra konkrete për angazhime në shërbim të anëtarësisë



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), ka mbajtur takimin e radhës me Kryetarët e Niveleve Komunale dhe të Universiteteve të Sindikatës, ku i ka diskutuar zhvillimet rreth vizitës së mësimdhënësve në bregdetin shqiptar.

Në takim, fjalën përshëndetëse e bëri kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj. Ai i uroi pushime të këndshme të gjithë mësimdhënësve që këtë vit do ta frekuentojnë bregdetin shqiptar me organizim nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës. Kurse, nënkryetarja e Sindikatës, Vjollca Shala, tha se listat e mësimdhënësve të cilët do të shkojnë në pushim me organizimin e SBASHK-ut, janë në procedurë të verifikimit.

Ndërsa, Koordinatori për Organizim të Brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri tha se numri i pjesëmarrësve është rritur në mbi 400 mësimdhënës që do të pushojnë sivejt në bregdetin shqiptar. Ymeri kërkoi respektimin e vendimeve të nxjerra nga sindiakta në mënyrë që të mos



ndodhin probleme në akomodimin e mësimdhënësve në bregdetin shqiptar, ku mësimdhënësit do të qëndrojnë për 5 netë.

SBASHK-u në këtë takim ka diskutuar edhe për veprimet e ardhshme sindikale, me të cilat do të kërkoi rritjen e koeficientëve për të gjitha kategoritë e mësimdhënësve në Kosovë.

Në takim u diskutuan disa veprime të mundshme sindikale, të cilat do të diskutohen me anëtarët e komunave dhe të merret vendimi për veprimet e mundshme sindikale, para përfundimit të vitit shkollor 2023/24.

Nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala, ka njoftuar edhe për takimin e grave të SBASHK-ut në Shqipëri në kuadër të „Fuqizimit të grave në Sindikatë“ vikendin që shkoj, ku tha se janë mbajtur takime edhe me dy sindikata nga Shqipëria, me të cilat u shkëmbyen përvojat e sindikatave respektive. Ajo njoftoi edhe për trajnimet që SBASHK është duke i mbajtur aktualisht.

